

LOJA ME ESHTRA



Nuk vdes kurrë
ashti juaj i fortë
themeli i lirisë
shtyllë e pa rrenueshme
e Nënës Kosovë
Për djepin e Dukagjinit
lulet e gjakut
te mos thahen
lule u bëtë
mbi kaptyell
rreth kokës se nënës
qe mbante kurorën e pritjes.
Rrënuat kullat e lavdit
luftërave të humbura
Batajnicen e bëtë varr
dhe fluturouat si dallëndyshet
pran gjakut të ngrohtë
të nënës Kosovë
ne Parkun e të pavdekshmeve
shndritë figura e juaj flamur.
Malli për ju
si uji deti
jeni te gjallë
uron me zë poeti.

Wuppertal, e diel, 2006-09-17

Kryqëzimi i Ironive

Në qendër të qytetit
u kryqëzuan dy ironi
në dy drejtime të kundërta
përcilleshin e priteshin
nga e njëjta gardë
e tupan,
të dyja i lidhte
një regjim satan.
Semafori i kuq u hap
nder varreza
të shkonte gjeneral
konferencash të thyera
në anën tjetër
zogj të zënë rob
fluturuan nga burgjet serbe,
te dytë i përcillte
një regjim satan
njërin për në varr
tjetrin për në Hagë
Sa i çuditshëm me dukej
kryqëzimi i dy ironive
qe nuk e shihnin njëra tjetrën,
ose ishte një ironi
e ndarë dysh.

Maj. 01. Gjakovë

KOBI

E ka një fill
im nuk është i
ka një rrugë
imja nuk është e
ka një këngë
pa solin tim
ka një hap
me marshin
tim
ka një fat
dhe emrin
tim.

Wuppertal-9.12.2000.

UDHA IME THIKA IME

Udha ime
Kullë e pa shkelur
me këmbë te zbathura
ti kam puthur majat
thik të përgjakura
Thikë e përgjakur
në rreshtin tim futesh
ma thikos marrshin
ma thikos vargun
edhe lulet në kopsht...
...thikë e stërthikët
dorezë e ime
derëzezë e njohur.
o thika ime
o hija ime
si nuk u ndeshet njëherë
ta preni njëra tjetrën
për vdekje.
Wuppertal, 98

Kërthizomania

Lufta nuk kishte përfunduar,
binave u vinte erë ndyrësirë
e prapë luftohet
për ti riokupuar
me milimetra,maten..
për tu ndarë pol..pozicionet
e eksponateve, muskujve
kërthizave, gjokseve,
kokëlakuriqve
era e fëlliqët e bynës
nuk pengon njeri....
...erë..... qe se ndien
erën...

.....

Në mes të verës mërdhij
nga ekspozime
lakuriqë e patriotik.

Korrik 2000. Gjakovë

Vershimë malli

Jam un bregdet
a breglumi
edhe i shpërlarë
edhe i plagosur
edhe i rrahur jam
degdisur valësh
edhe zëmër e Tsunamit
vërschim behëm
brigjeve të zemrës
sa herë me thanë malli
për Kosovën

2004. Düsseldorf

Luani i plagosur

Mos e ngacmo Luanin
kur i plagosur është
plagën me plagë e shëron
Luftëtarin e armatosur
mos provo
ta ç'armatosesh
se më parë i zbrazë
njëmijë fishekë
Peshkatarit mos ja merr rrjetin
se peshkaqen bëhet
e vërshim deti
vargjet mos ja prek
se me to mund të
vret edhe poeti.

2004. Wuppertal

Orëbardha e barrërënda

Dallëndyshet e Shirokës
nuk mu kthyen
qorradresës sime
me ndjek një zog
me kaqulëz mbi kokë
me një zë të thekur
o ne e quajmë "zogu i babait"
kur me vdiq babai
gjithë natën ciu-ati
te dritarja
te dera
te babai në dhomë
edhe pse i kishte shpëtuar
rrugës se Tivarit ma mori
ne mëngjesin nëntëdhjetenjë-të.
Kapërcyellit të shtegut të përgjakur
cicërima e tij më mori
edhe gjashtë copa zemre
më mori dhe shumë miq
"Zogu i babait "çka do
qe sot me përcjell ?
mi kthe Dallëndyshet
ose merre edhe zemrën
time të plagosur.
Mos mu bë shok poezie
as jete o zogë o
Dallëndyshe bëhu
nëse i Shenjtë nuk je.

Edhe Djalli vdes

Djallin e varrosem jashtë
Oborrit të shtëpisë
së përgjakur
të Kosovës
mos të ringjallet
varrin ja bëmë të madh
sa gazi(m..)estani
ta pështyjnë kalimtare
dhe mos t'ja harrojmë
emrin
babai im thoshte
nëse ja harrojmë
emrin qoftë largut
ai ringjallet.

Dialog Këngësh

Kosovë!

Lule dhembje mbolla
mbi varrezat e fundit
ngrohtësisht i përkund
në djepin e përgjakur
më lot e shpresë i ujis
të rritën,të rritën
roje u bëj e ninulla ju këndoj
në djepin e vet dardan
rritës mos të pritën
rritës mos të priten.
Telat e muzës së ringjallur
kërkojnë meloditë e veta
guacave të strukur
shkëmbinjve te rrahur
e luleve degëthyera
zjarrëgjoksave të shpaluar
e të shpuar zjarresh
ofshamave që humben një ninullë
ninullave qe jehuan zë të ri

Telat i ringjallen muzës sime
okarinë e lashtë ilire
nga eshtrat e shpuar
gjatë një këngë të lashtë
të kompozojë melodinë e lindjes
emrave qe vala mi mori
emrave qe vala mi solli
te shartuar kopshteve
melodi e mbajtur thellë në zemër.
Botë e trazuar botë!
Regjistroje në pentagramin e ringjallur
këtë melodi të rilindur
në të dardanësh tokë
Botë e trazuar botë!

Shohë me zemër

syri im i qenit
shpesh rritet
në anën time te majtë
maje kullash ulërin
zi e sheh diellin
a kuq a?

Qençe...

Syri im i djathë
shpesh leh
në syrin e qenit
kur Kullat tona virgjër
puthin qiellin epshplot.

Ah zot i madh
a mos i ke lidhur keq
syrin tim te majtë
syrin tim të djathtë
me një bjeshkë ne mes.

Mbi krahët e Agut ose pavarësia e një rruge

Mbi krahët e zhveshur
barta diellin në cep të krahëve
të mi të regjur
deri në majë Mali
malit tim shpeshherë të djegur
që të mos rigojë pluhur vdekje
stinëve të mija të përçara
stinëve të mija të djegura
e me thonjtë e përgjakur
tunda majat e stinëve të zverdhura
qe t' u shkundë të sertat gjethe
gjethe të mplakura të kohës sime halore

Ja shohë fundin
shtegtimit tim rrugë-rruge
deri të rreze-rrezesh e Agu
deri të Ag- Agu i rrezeve të ndrydhura
rrugës sime të përgjakur
rrugës sime majerrugë
dhe rrugëtar i lumtur jam
qe isha fanar i shtegtimit
dhe shndritur kam
mugëtirës hijezezë
stinëve të mija të sertllisura.
Rruga ime e drejtë
çdo udhëkryqi kam lënë lëkuren.
Rrugë e dhembjeve kalistrof
bartem njëri tjetrin
deri në cikor të dashurisë.

06/02/06, Wuppertal